



Republika e Kosovës
Republika Kosovo-Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština - Assembly

Legjislatura IV
Sesioni pranveror

Komisioni për Integrime Evropiane
Mbledhja nr. 91
Prishtinë, më 04.02.2014, në orën 11:00
Ndërtesa e Kuvendit, salla N-225

PROCESVERBAL
I MBLEDHJES SË KOMISIONIT PËR INTEGRIME EVROPIANE

Në mbledhje morën pjesë: Vjosa Osmani, Blerta Deliu-Kodra, Ismet Beqiri, Alma Lama, Blerim Shala, Suzana Novobërdali, Albert Kinolli dhe Sasha Milosavljeviq.

Munguan:, Xhavit Haliti Glauk Konjufca dhe Fatmir Limaj

Stafi Mbështetës i Komisionit: Ahtere Loxha, Safet Beqiri dhe Florent Mehmeti

Mbledhjen e kryesoi, Vjosa Osmani, kryetare e Komisionit.

RENDI I DITËS:

1. Miratimi i rendit të ditës;
2. Miratimi i Procesverbalit nga mbledhja e dt. 27.01.2014;
3. Shqyrtimi i Planit të Veprimit për negocimin e Marrëveshjes së Stabilizim Asocimit për vitin 2014;
4. Shqyrtimi i Projektligjit. nr. 04/L-230 për Agjencinë e menaxhimit emergjent, me amendamentet e Komisionit funksional nga aspekti i përputhshmërisë me legjislacionin e BE-së;
5. Të ndryshme

Kryetarja konstatoi se janë plotësuar kushtet për fillimin e punës dhe e hapi mbledhjen.

1. Miratimi i rendit të ditës

Kryetarja propozoj që pika e katërt e Rendit të ditës të bëhet pika e tretë, sepse pika e tretë do të merë më shumë kohë për tu shqyrtuar.

Rendi i ditës u miratua me ndryshimin e propozuar.

2. Miratimi i procesverbalit

Procesverbali u miratua pa vërejtje

3. Shqyrtimi i Projektligjit. nr. 04/L-230 për Agjencinë e menaxhimit emergjent, me amendamentet e Komisionit funksional nga aspekti i përputhshmërisë me legjislacionin e BE-së;

Suzana Novoberdali gjatë raportimit kishte konstatuar se dispozitat e Projektligjit së bashku me amendamentet e komisionit funksional se nuk janë në kundërshtim me dispozitat e BE-së dhe si i tillë mund të procedohet për miratim në Kuvend

Kryetarja konstatoi se Komisioni njëzëri nxori këtë

Përfundim

Projektligji. nr. 04/L-230 për Agjencinë e menaxhimit emergjent, me amendamentet e Komisionit Funksional është në harmoni me Acquis Communautaire.

4. Shqyrtimi i Planit të Veprimit për negocimin e Marrëveshjes së Stabilizim Asocimit për vitin 2014;

Kryetarja tha se versionin e parë të këtij Plani e kemi miratuar në Kuvend vitin që shkoj i bazuar në raportin e progresit të vitit 2012, ne kemi shqyrtuar vitin e kaluar, Qeveria tani e ka ndryshuar konform Raportit të progresit të vitit 2013, natyrisht janë bërë ndryshime duke pas parasysh tre kapitujt apo titujt që janë përfunduar së negociuari, pasi që është dokument voluminoz prej 300 faqesh, propozoj që sot të diskutohen kriteret politike, kurse për pjesën tjetër të mërimi vesh për një punëtori ditore. Arsyeja pse duhet ta shqyrtojmë në detale është sepse në momentin kur miratohet në Kuvend e mëre edhe autorësinë e Kuvendit. Të jemi të kujdesshëm tek pjesa e obligimeve të Kuvendit.

Kishte përgatitur disa propozime për ndryshime dhe ftoj anëtarët që së bashku ti shqyrtojnë.

Në hyrje të dokumentit tha se kishte një vërejtje e cila do të ju duket teknike, por nga aspekti juridik është shumë me rëndësi ,atëherë për të qenë në përputhje me vendimin e GND, ku autorësia e shpalljes së pavarësisë janë vet qytetarët e jo institucionet, duhet të ndryshojmë si në vijim: Me 17 shkurt Kosova është shpall shtet i pa varur dhe sovran.

Anëtarët e komisionit u pajtuan një zëri për ndryshimin e propozuar.

Kurse në fund të fjalisë Qeveria thotë se Plani i Veprimit në Kuvend dorëzohet për njoftim, nga praktikat e mëparshme Plani i Veprimit miratohet, andaj propozoj që „fjala njoftim të zëvendësohet me miratim”.

Tek kriteret politike, pjesa e parë fillon me pjesën legislative me obligimet e Kuvendit, obligim i parë që është parapa në pjesën narrative është obligimi për Kuvendin, pasi që nuk është parapa pavarësia buxhetore e Kuvendit, propozoj që të shtohen fjalët „në Projektligjin për Kuvendin apo me akte tjera normative për Kuvendin”.

Alma Lama tha se tek vlerësimi që ka bërë Komisioni Evropian theksohet çart mungesa e pavarësisë financiare, propozoj të iniciojmë hartimin e Projektligjit për pavarësinë buxhetore për Kuvendin, të shikojmë modelet më të mira dhe t’ia kalojmë Kuvendit se Qeveria nuk është ajo që dikton punën e Kuvendit, por në rast se nuk do të ndodh kjo Komisioni Evropian do të na sjell të njëjtat vërejtje që Kuvendi i nënshtrohet Qeverisë.

Kryetarja tha se nuk kishte asgjë kundër këtij propozimi, një ditë të ulemi dhe në veçanti të diskutojmë për iniciimin e projekt ligjit.

Propozoj që në këtë paragraf të shtohet edhe „pavarësia buxhetore e Kuvendit”.

Në takimet homologe me Komisionet për çështje Evropiane kemi par se ato kishin kompetenca të veçanta që është dhënia e mandatit negociues, kjo nënkupton që sa herë të shkoj Qeveria në BE, të negocioj çështjet që kanë të bëjnë me integrimin Evropian, para se të shkoj duhet të merë mandat se çka i lejohet të negociohet e çka nuk i lejohet, këtë kompetencë e kanë shumica e shteteve .

Propozoj ta fusim këtu si një prej çështjeve që edhe në rregulloren e re të Kuvendit të futet si kompetencë shtesë.

Për këtë propozim pyeti anëtarët se a pajtohen.

Suzana Novoberdali këtë propozim e konsideron kufizim si të punës së Qeverisë, të merret gjithmonë leje prej Komisionit sa herë që shkohet në negociata.

Kryetarja tha se shumë shtete e kanë këtë praktik për çështjet evropiane dhënia e mandatit negociues. Nuk është kjo praktik që po bëhet për herë të par, nëse dëshirojmë që mos të përsëritet çdo herë në Raportin e progresit për mbikëqyrjen parlamentare atëherë ne duhet ti fuqizojmë komisionet me dhënien e kompetencave

Blerta Deliu pajtohet të rritet roli mbikëqyrës i Komisionit, sepse është edhe vërejtje gati në çdo raport të progresit, por për çdo takim në Bruksel të merret mandati nga Komisioni, mendoj se mos po tejkalohen kompetencat e Komisionit, prandaj do të ishte mirë të konsultohemi në punëtorin e radhës të mëren mendimet dhe ta vlerësojmë si deputet.

Alma Lama theksoi se dhënien e mandatit negociues Komisionit, e shoh brenda logjikës demokratike, sepse Kuvendi është nga të zgjedhurit e popullit dhe duhet ta japin mandatin të diskutohet për çështjen e caktuar, të mos bëhen hapa të gabuar gjatë procesit, të konsultohen paraprakisht me Komision që ta merë mandatin, nuk është e thënë që të

diskutohet çdo detaj, sepse Qeveria është ekzekutuese, por për linjat kryesore duhet të sqarohen në Komision dhe të arrihet ai konsensus i duhur, sepse Komisioni është i përfaqësuar nga të gjitha grupet politike. Ishte dakord që të sqarohet në takimin e ardhshëm.

Ismet Beqiri pajtohet që të ketë një mandat të tillë, pasi jemi republikë parlamentare dhe nuk shih asgjë të keqe. Kjo nuk bëhet për një Qeveri apo tjetrën që vjen, por bëhet për Kosovën dhe të ardhmen e saj dhe nuk duhet ti frikohemi praktikave të tilla, sepse pa një koordinim të mirëfilltë të ministrive përkatëse dhe Komisionit nuk do të ndihmojmë proceseve që na presin dhe nuk duhet ta shohim si pengesë forcimin e rolit të Komisionit.

Blerim Shala tha se Qeveria nuk mundet asgjë me negociu për procesin e Integritimeve Evropiane pa vendimarrjen e Kuvendit të Kosovës, andaj po frikohem se po ia marim kompetencat e Kuvendit, gjithsesi pajtohem në mbikëqyrjen parlamentare dhe ka qenë edhe më par praktik që kryetari i Komisionit për Integritime Evropiane të merë pjesë në takime për çështje të rëndësishme të Integritimeve evropiane, me sa e di unë edhe z. Haziri merrte pjesë, andaj edhe tani, duhet bërë tryzni që kryetarja e komisionit duhet të merë pjesë nëpër takime në Bruksel. Është e drejtë e ministres së Integritimeve Evropiane që sa herë të ketë takime të rëndësishme në Bruksel ta sqaron mandatin para komisionit. Të gjithë po flasim njësoj për këtë çështje por nuk po mëremi vesh për gjuhën e saj. Pajtohem të flasim parimisht, jo për këtë Qeveri apo për tjetrën që vjen, sepse do të shkojnë edhe disa tjera deri sa Kosova të hyjë në BE.

Kryetarja tha se nuk është fjala për çështje të mëdha si negociatat për MSA-në sepse atë mandat ia ka dhënë Kuvendi Qeverisë, por për çështje më të vogla të vjen ministrja në komision dhe të sqarohet.

Pas diskutimeve lidhur me mandatin negociues të Komisionit u vendos të diskutohet në mbledhjen e radhës.

Kryetarja- Te pjesa narrative tek legjislativi propozoj të futet rritja e kapaciteteve për përputhshmërinë me Acquis communautaire në Kuvend, sepse kjo vërejtje është përsërit disa herë në Raportin e Progresit.

Pastaj kaloj tek pjesa e obligimeve të Qeverisë dhe pyeti se a ka vërejtje.

Alma Lama tha se Qeveria është ajo që harton dhe ka kapacitetet me ekspertizë për hartimin e Projektligjeve, por duhet të jetë më e përgjegjshme, sepse në për mungesë të kapaciteteve të ekspertizës po i shqyrtojmë projektligjet po i miratojmë por prapë brenda një viti, po na kthehen për plotësim dhe ndryshim, sepse Komisioni Evropian po bënë vërejtje.

U pajtuan që te pjesa narrative tek legjislativi të përfshihet rritja e kapaciteteve për përputhshmërinë me Acquis communautaire në Kuvend.

Kryetarja vazhdoj tek pjesa e reformës në administratën publike, konstatoj se nuk është përfshi në Planin e veprimit vërejtja e raportit të progresit që ka të bëjë me politizimin dhe nepotizmin në administratën publike.

Propozoj që institucionalisht të marim masa urgjente dhe konkrete kundër politizimit dhe nepotizmit, sepse nuk mund të konsiderohet komplet reforma.

Propozimi u miratua nga anëtarët e komisionit.

Tek shoqëria civile, propozoj të shtohet –Bashkëpunimi i shoqërisë civile me Kuvendin.

Tek gjyqësori tha se kur flitet për alternativat të zgjedhjeve të kontesteve flitet vetëm për ndërmjetësim, propozoj të përfshihet arbitrazhi.

Në raportin e progresit si vërejtje është ndërhyrja politike në gjyqësi dhe polici, por kjo nuk është fut në raportin e progresit.

Propozoj të meren masa për të parandaluar dhe dënuar ndërhyrjet politike në gjyqësi dhe polici dhe të ketë masa konkrete për mbrojtjen e tyre dhe familjarët, kur ata e shohin të nevojshme.

Alma Lama tha se ky dokument është hartuar duke mos i përfshirë vërejtjet kryesore si ndërhyrjet politike në gjyqësi dhe në reformën e administratës. Duke pas parasysh numrin e madh të lëndëve të pa zgjidhura dhe numrin e vogël të prokurorëve dhe gjyqtarëve dhe buxhetin që e kanë, ne nuk mund të kërkojmë llogari pse nuk po zgjidhen lëndët.

Krahasuar me kokë banori numri i gjyqtarëve dhe i prokurorëve është vogël dhe secili prej tyre është shumë i ngarkuar dhe Qeveria nuk ka paraparë rritjen e buxhetit edhe pse ka caktuar buxhet të lartë për luksin, andaj propozoj si vërejtje rritjen e buxhetit për gjyqësi dhe prokurori dhe rritjen e gjyqtarëve dhe prokurorëve.

Suzana Novoberdali u ndërlidh duke shtuar se gjyqtarët punojnë sipas normës dhe përgjigjen mund ta maresh vetëm në këshillin gjyqësor.

Kryetarja pyeti anëtarët se a pajtohen që dy propozimet e Alma Lamës, të përfshihen si rekomandime në Planin e Veprimit.

1. Rritja e buxhetit për gjyqësi dhe prokurori
2. Rritja e numrit të gjyqtarëve dhe prokurorëve

Propozimet u miratuan nga anëtarët.

Sasa Milosavljević pajtohet me propozimin që të ketë rritje të numrit të prokurorëve dhe gjyqtarëve, propozoj të përfshihet në Planin e Veprimit edhe rritja e numrit të gjyqtarëve dhe prokurorëve edhe nga komuniteti serb.

Kryetarja e njoftoj se është e përfshirë kjo çështje në Planin e Veprimit e MSA-së.

Vazhdoi tek politikat e korrupsionit dhe pyeti se a ka vërejtje.

Alma Lama tha se të teksti në fillim ku thuhet se korniza ligjore është e kompletuar, bie ndesh me ligjet miratuara në Kuvend kundër korrupsionit, sepse të gjitha ligjet e miratuara, brenda vitit po kthehen prapë për plotësim dhe ndryshim. Andaj propozon të thuhet se korniza ligjore është me mangësi të mëdha.

Kryetarja tha se një numër i madh i ligjeve që janë paraparë në Plan për tu miratuar, veç janë miratuar nga Kuvendi i Kosovës, pastaj ka ligje që përmenden në Planin e veprimit e nuk janë përfshirë në agjendën legislative të Qeveris.

Andaj propozoj që së pari ta analizojmë listën e ligjeve paraprakisht të dimë se sa ligje kanë mbet të miratuara nga kjo fushë dhe pastaj të dalim me propozime.

Tek te drejtat e njeriut dhe mbrojtja e minoriteteve.

Kryetarja propozoj që kur flitet për të drejtat pronësore, të shtohet të drejtat pronësore të grave, sepse për deri sa kemi vetëm 2% të grave që realizojnë të drejtën pronësore, nuk mund të thuhet se kjo fushë është e avancuar.

Suzana Novoberdali theksoi se kjo është e përfshirë në Ligjin për Trashëgimin dhe në Ligjin për pronën, por tjetër është se te ne shumica e femrave heqin dorë vet nga pasuria. Ligjet janë të mira dhe po zbatohen në gjykatë.

Kryetarja tha se ligji është i mirë dhe parasheh barazinë gjinore, por nga aspekti praktik nuk po implementohet, në Maqedoni ishte një praktik e mirë dhe mendoj se edhe ne duhet ta përfshijmë dhe Kuvendi nuk duhet të jetë aq i ngurtë sa që mos me pa praktika ma të mira.

Albert Kinolli tha se në tekstin e këtij Plani po përmendet termi pakica, propozoj që kjo të ndryshohet dhe të zëvendësohet me komuniteti pakicë.

Kryetarja me miratimin e anëtarëve kërkoj që në tërë tekstin e Planit të Veprimit të MSA –së termi pakicë të zëvendësohet me termin komuniteti pakicë.

Në vazhdim propozoj që në fund të shtohet „Institucionet e Kosovës të respektojnë obligimin e tyre kushtetues.”

Tek pjesa tabelare është përfshirë në tekst amendamenti i kushtetutës dhe përfundimi i reformës zgjedhore, propozoj të largohet fjala amendamenti i kushtetutes dhe të mbetet ndryshimi i ligjit për zgjedhje.

5. Të ndryshme

Kryetarja kërkoj që gjatë javës së ardhshme në një punëtori një ditore të jenë të gjithë prezent dhe të vazhdohet me shqyrtimin e Planit të Veprimit për MSA-në dhe të

përfundohet dhe të dorëzohet në Kuvend për miratim me rekomandime, u dakorduan që gjatë muajit shkurt të ftohen ministrat të cilët ishin paraparë në Planin e punës dhe realizimin e vizitave për përmbylljen e monitorimit të zbatimit të Ligjit për Ripranim dhe fillimin e monitorimit të zbatimit të Ligjit për kompetencat e zgjeruara për konfiskimin e pasurisë së fituar me vepër penale .

Mbledhja përfundoj në orën 12;00

E përgatiti:

Kryetare e Komisionit

Njësia për Mbështetjen e Komisionit.

Vjosa Osmani